REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

NJOFTIM

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar; VKM-së nr. 132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa", si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 78, datë 25.11.2025 "Për përcaktimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026" në Bashkinë Prrenjas:

- Bashkia Prrenjas sjell në vëmendje për të gjithë qytetarët dhe subjektet tatimpaguese se po afrohet afati përfundimtar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Pasuritë e Paluajtshme (Tokë, Truall dhe Ndërtesë: njësi shërbimi, objekte banimi, magazina) Tarifave të shërbimeve për vitin 2026, si dhe detyrimeve të prapambetura.
- Ju bëjmë me dije se në zbatim të ligjit 86/2025:
  - Fshihen detyrimet deri në vitin 2014
  - Pagesat e prapambetura 2015-2019 kanë zbritje 25%
  - Për vitet 2020-2024 fshihet kamatvonesa.

Përfitojnë zbritje të gjithë qytetarët që paguajnë detyrimet deri më 31.12.2026.

Afati i pagesës është data 31 dhjetor 2026. Mospagimi brenda afatit sjell kamatvonesë 1.8% për çdo muaj vonesë (jo më shumë se 12 muaj).

Për çdo sqarim, paraqituni pranë Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Prrenjas ose pranë Njësive Administrative.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

Adresa. Rruga : "Skënderbeu", Godina: 15, Tel. 05912/2404/ 22605, www.bashkiprrenjas.gov.al, e-mail:bashkiaprrenjas@hotmail.com